

ZAMIRA ALIMEMAJ

TIPARE TË SISTEMIT FONETIK TË LABËRISHTES

Përmbledhje

Po të ndiqet hap pas hapi lindja dhe zhvillimi i tipareve të dy dialekteve të shqipes, duke nisur nga ato më të rejtat e duke shkuar tek ato më të lashtat, shihet se ato së bashku me shumë veçori të të folmeve të veçanta janë forma të ndryshme që ka marrë kohë më kohë brumi i vetë gjuhës shqipe. Në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme kualitative në intonacione dhe dallimi në gjatësinë e zanoreve nuk është absolut e as relevant, sepse zanore të gjata gjenden në gegërishte, por edhe në të folmet e labërishtes, të çamërishtes dhe arbërishtes. E folmja (apo të folmet) e Labërisë është relativisht e njohur nga studimet dialektologjike të botuara. Dallimet dialektore të sistemit fonetik janë të llojeve të ndryshme dhe jo të një rëndësie nga ana funksionale për shkallën e largimit të dialekteve. Për të dalë më qartë dallimet fonetike të labërishtes kundrejt të folmeve të tjera, më poshtë do t'i paraqitim këto dallime sipas kategorive.

Fenomenet fonetike

1. Shurdhimi

Në të folmen e Labërisë janë shurdhuar bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës dhe në mes të saj para një bashkëtingëlloreje të shurdhët: *shelek* (sheleg), *shtek* (shtegu), *zoq* (zogj), *borç* (borxh), *mleth* (mbledh), *prokof* (prokov), *u loht* (u lodhët), *laksht* (lagësht), si dhe para bashkëtingëlloreve hundore: *erthm* (erdhëm).

- Këmbimet në mes të fjalëve janë më të pakta: *trathtar* për tradhtar, *bakabon* për vagabond, *trektar* për tregtar etj.
- Këmbimet në fund të fjalëve: *brek* për breg, *munt* për mund, *mënt* për mend, *qëng* për qëngj, *ndes* për ndez, *vënt* për vend, *tent* për tend, *luk* për lug, *lark* për larg, *mës* për mëz, *kukuth* për kukudh, *u loth* për u lodh, *breth* për bredh, *xjeth* për zgjedh, *u verth* për u verdh, *djek* për djeg, *lith* për lidh, *heth* për hedh, *trek* për treg, *vjeth* për vjedh, *dhëmp* për dhëmb, *u lak* për u lag, *shtek* për shteg, *shelek* për sheleg, *serios* për serioz, *funt* për fund, *lint* për lind, *pellask* për pellazg, *xbarth* për zbardh, *njërs* për njerëz etj.

Fenomeni i shurdhimit në të folmet labe paraqet një interes të veçantë jo vetëm për zhvillimin, por edhe për kronologjinë e tij.

1. Në fshatrat e Bregut të Poshtëm (Piqeras, Nivicë-Bubar) bashkëtingëlloret e zëshme fundore nuk shurdhohen.
2. Në Delvinë e Gjirokastrë fenomeni i shurdhimit është ende në gjysmë të rrugës.
3. Në Kurvelesh, Rrëzomë ato janë shurdhuar.

2. Sonorizimi

Ka raste kur disa bashkëtingëllore të shurdhëta bëhen të zëshme. Ky fenomen fonetik vihet re edhe në të folmen e Labërisë, kryesisht tek brezi i vjetër i banorëve të kësaj krahine:

- *k > g*: *portogalle* (portokalle), *përgëdhel* (përkëdhel), *egzekutiv* (ekzekutiv).
- *s > z*: *azgjë* (asgjë), *mezditë* (mesditë), *Mezdhe* (Mesdhe), *mezdhëtar* (mesdhëtar), *zorkadhe* (sorkadhe), *Zadiku* (Sadiku), *zixhade* (sixhade).
- *t > d*: *gode* (gotë), *digan* (tigan), *kapiden* (kapiten).
- *ç > xh* ose *zh*: *xhdo* ose *zhdo* (çdo).

3. Asimilimi

Është një nga dukuritë fonetike që ka vepruar dhe vazhdon të veprojë edhe sot në dialekte. Me asimilimin reduktohen grupet e tingujve duke u shkruar me njëri-tjetrin e duke na dhënë një tingull tjetër që i ruan tiparet e dy të parëve ose te njërit prej tyre. Në të folmen e Labërisë vihen re raste të ndryshme asimilimesh.

Po renditim disa lloj asimilimesh:

- A) Asimilim zanor: a) progresiv: *kraharuar* (krahëruar), *thithilopa* (thithëlopa), b) regresive *profesjon* (profesion), *darovit* (darovit), *rrutulloj* (rrotulloj).
- B) Asimilim bashkëtingëllor jo në kontakt: a) regresive: *kshish* (ksish), *nisheshte* (niseshte)
- C) Asimilime konsonantike në kontakt:
 - a) Asimilime të pjesshme. Ndër më karakteristiket për këtë të folme, sidomos në fshatrat e Kurveleshit, është asimilimi i dybuzores /p/ në dybuzoren hundore /m/ para hundores /n/: *hamn* (hapnë), *imni* (jipni), *imn* (hipën), *shtymni* (shtypni), *mo e rimni* (e ripni).
 - b) Asimilime të plota: asimilimi i grupit /tn/ në /n/: *kulloni* (kullotni), *prini* (pritni), *godin* (goditën), *grabin* (grabitën).

/tm/ në */m/*: *e pam llafin* (patmë), *u përshënem* (u përshëndetëm), *gjëm* (gjetmë).

/ln/ në */l/*: *dili* (dilni), *mual* (mualnë), *vual* (vualnë).

/lln/ në */ll/*: *duall* (duallnë), *puall* (puallnë), *i përcilli* (përcillni).

/rn/ në */rr/* dhe */r/*: *muarr* (muar, muarnë), *nxuarr* (nxuarnë), *tirri* (tirrni), *mirri* (mirrni).

/rrn/ në */r/*: *e mirr* (mirrnë), *të nes zjarr* (zjarrnë).

/dhn/ në */dh/*: *hodh* (hodhnë), *mlodh* (mlodhnë).

Reduktimi i këtyre grupeve të bashkëtingëlloreve është kryer rregullisht kudo në të folme të toskërishtes, ashtu si dikur në mbarë shqipen. Në të folmet skajore të Jugut, sidomos në labërishte, ky proces është sot një normë fonetike e gjallë, sepse shihet se vepron edhe në forma të dëftores së tashme: *dili* (dilni), *meri* (merrni). Në këto të folme ekzistojnë si variante edhe forma të rindërtuara, në të cilat nuk del i reduktuar grupi: *malnë* (malin), *dualnë* (dolën)¹.

Asimilimi është karakteristikë edhe e të folmeve të tjera si: e folmja e Muzinës², e folmja e Gjirokastrës,³ e folmja e Delvinës.

Ka raste kur në disa të folme, në disa grupe bashkëtingëlloresh, sidomos nga ato të formave të vjetra të kallëzores e ato të së kryerës së thjeshtë, janë të paqëndrueshme, njëri prej elementeve reduktohet plotësisht, p.sh.: *malë* (malnë), *mbenë* (mbetnë). Historia tregon se në faza më të hershme të zhvillimit të saj grupe të tilla bashkëtingëlloresh kanë qenë të kufizuara në numër dhe kanë pësuar ndryshime duke u reduktuar njëri nga elementet e tyre, ashtu si vërehet sot në të folmen skajore të toskërishtes: të folmet e skajit lindor (Korçës, Kolonjës, Pogradecit), ato të skajit jugor (të Labërisë, të Çamërisë, me përjashtim të së folmes së Gjirokastrës) dhe të folmet e zonave qendrore malore (Skraparit, Përmetit, Zagorisë). Në këto të folme ekzistojnë si variante edhe forma të vjetra të kallëzores së shquar të emrave mashkullorë njëjës që u mbaron tema me bashkëtingëllore: *miknë* (mikun), *detnë*, *denë* (detin), dhe forma të së kryerës së thjeshtë të foljeve me bashkëtingëllore: *hipnë* (hipën), *mbathnë* (mbathën).⁴

¹ J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 239.

² M. Totoni, *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, "Studime filologjike", 3, 1965, f. 106.

³ M. Kore, *Gjirokastra*, Tiranë, 2014, f. 122.

⁴ J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 234.

Ky fenomen fonemik është karakteristikë për të folmen e disa fshatrave të Labërisë, kryesisht në zonën e Kurveleshit. Po sjellim disa raste:

- Tingulli /**n**/ bie pothuajse rregullisht kur ndodhet para /**xh**/-së dhe para /**x**/-së: *pexhere* (penxhere), *texhere* (tenxhere), *u xituam* (u nxituam), *xehej* (nxehej).
- Tingujt /**s**/ dhe /**th**/ bien kur ndodhen para /ç/-së: *të vraç* (të vrasç), *të heç* (të hethç), *u loç* (u lothç).
- Raste të tjera: *gëshër* (gërshërë), *këcej* (kërcej), *xhesh* (xhvesh), *vështoj* (vështroj), *ile* (hile), *gjan* (ngjan), *ipni* (jipni), *ini* (jini), *mëlcoj* (ëmbëlsoj).

4. Disimilimi

Disimilimi ndodh kryesisht gjatë procesit të fjalëformimit apo krijimit të formave gramatikore, kur zgjerimi me parashtesa, prapashtesa apo mbaresa kanë një bashkëtingëllore të njëjtë me rrënjën. Ky fenomen është shumë i rrallë në të folmen e Labërisë: *fëldish* (fildish), *nëmur* (numur), *birbili* (bilbili).

5. Fenomeni i shtimit të tingujve

Ka raste, kur si rezultat i zhvillimeve të brendshme të gjuhës, shfaqen disa fonema pa ndonjë funksion të caktuar:

- **proteza** (tingulli shfaqet në fillim të fjalës): *të ndrejtën* (drejtën), *nderisa* (derisa), *hunazë* (unazë), *harmë* (armë), *harrin* (arrin), *hilaçe* (ilaçe), *havash* (avash);
- **epenteza** (tingulli i shtuar shfaqet në mes të fjalës): *adresë* (adresë), *drangua* (dragua), *zëmbër* (zemër), *bucjelë* (bucelë), *ëmbër* (emër), *çelnik* (çelik), *burdalla* (budalla), *mbrekulli* (mrekulli), *fambrikë* (fabrikë), *e mistërt* (e misërt), *ngjollë* (njollë), *barxho* (baxho), *rrëngjethem* (rreçqethem), *të mbeta* (të meta), *shelqer* (sheqer);
- **epiteza** (tingulli i shtuar shfaqet në fund të fjalës): *i dobërt* (i dobët), *tyja* (ty), *andeja* (andej), *nashinë* (tani).

6. Elizioni

Një nga karakteristikat e të folmes së Labërisë është elizioni. Përpara nyjes së përparme **e** bie nyja e prapme **a**: *kocje vogël* (kocja e vogël), *kasolle dhive* (kasollja e dhive), *vatre zjarrit* (vatra e zjarrit), *lulje bardhë* (lulja e bardhë) dhe nyja e përparme **i** pas emrash në trajtën e shquar nuk ndihet: *djali mbretit* (djali i mbretit), *parmaku portës* (parmaku i portës).

7. Kontraktimi i zanoreve

Ky fenomen vihet re kryesisht në të folmen e Bregut të Detit dhe disa zona të Kurveleshit.

- Toçu /*ëe*/ që lind nga /*ë*/ e pjesëzës *të* dhe trajta e shkurtër *e*, herë kontraktohet në *a* e herë jo: *do t e marrëm, van t e kërrejnë*.
- Toçu /*ëe*/ që lind nga bashkimi i trajtave të shkurtëra të përemrit vetor *më+e* haset i kontraktuar në *a*: *do ma zëç vajzën, do ma marrç të keqen*.
- Toçu /*ae*/, që lind në gjinoren e emrave patronimikë pas rënies së /*j*/, si dhe në urdhëroren e disa foljeve, kontraktohet në /*e*/: *Ar e Dede* (Dedeje), *stan i Gjike* (Gjikaje, Gjikajve), *vre* (vrae) etj.
- Kontraktohet në /*e*/ toçu /*oe*/, që formohet në urdhëroren e foljeve me *-oj*, kur u shtohet pas trajta e shkurtër e përemrit /*e*/: *fërke* (fërkoe), *gërme* (gërmoe).
- Kontraktohet në /*i*/: nyja e mbrapme /*i*/ me nyjen e përparme /*i*/: *djali: math, kërciri: këmës*.

BIBLIOGRAFI

- Demiraj, Sh. (1996), *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Gjinari, J. (1989), *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Kore, M. (2014), *Gjirokastra*, Tiranë.
- Memushaj, R. (2001), *Lidhjet tradicionale të Kurveleshit me Vlorën*, Konferenca Shkencore “Vlora në rrjedhat e kohës”, Toena, Tiranë.
- Memushaj, R. (2003), *Rreth hipotezës së prejardhjes lab-Labëri, nga arbër-Arbëri*, Buletini Shkencor nr. 4, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Tiranë.
- Totoni, M. (1965), *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, SF, 3.
- Totoni, M. (1964), *E folmja e Bregdetit të Poshtëm 2*, SF, 2, Tiranë.
- Totoni, M. (1964), *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, SF, 1, Tiranë.
- Totoni, M. (1965), *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, SF, 3, Tiranë.
- Totoni, M. (1971), *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, “Dialektologjia shqiptare”, I, Tiranë.

GJUHËSI E ZBATUAR / A

